

LAPSH- Lidhja e Arsimitarëve dhe e Shkrimtarëve Shqiptarë në Zvicër

Historiku



Lidhja e Arsimitarëve dhe e Shkrimtarëve Shqiptarë “Naim Frashëri” është formë e organizimit të arsimtarëve dhe e prindërve shqiptarë në Zvicër. Ajo është organizatë jopolitike dhe jofetare. Lidhja e Arsimitarëve dhe e Prindërve Shqiptarë “Naim Frashëri” është bartëse e shkollës shqipe në Zvicër.

Lidhja e Arsimitarëve dhe e Prindërve Shqiptarë “Naim Frashëri”, si formë e organizuar e arsimtarëve dhe e prindërve shqiptarë në Zvicër, përkatësisht si vazhdimësi e Lidhjes së Arsimitarëve Shqiptarë (LASH) dhe Lidhjes së Prindërve Shqiptarë (LPSH), ekziston prej 26 marsit të vitit `95.

Për dallim nga organizatat e tjera shqiptare në Zvicër, ajo nuk është themeluar në bazë të ideve e nismave të individëve apo grupeve dhe nevojave të tyre vetjake ose grupe, por në bazë të nevojës së përgjithshme dhe të domosdoshme për përkujdesje arsimore e edukative të mijëra fëmijëve e të rinjve mërgimtarë në Zvicër. LAPSH “Naim Frashëri” është themeluar në bazë të nenit 3 të Dekretligjit për drejtimin e veprimtarisë edukative-arsimore të Qeverisë së Kosovës. Formimi i Lidhjes, bartëse e Shkollës Shqipe të Mësimit Plotësues, është bërë në Kuvendin e mbajtur në Zofingen më 26 mars 1995, si rezultat i Marrëveshjes paraprake mes dy Lidhjeve (LASH e LPSH) dhe ministrive të Arsimit të Kosovës, Shqipërisë dhe subjektit politik shqiptar të Maqedonisë.

Më 30 tetor 1995, LAPSH “Naim Frashëri” është pranuar zyrtarisht bartëse e SHSHMPZ-së nga Konferenca e Drejtorive Kantonale të Arsimit (EDK) dhe Komisionit Federal për Çështje të të Huajve (EKA).

Deri në vitin 2000, rrjeti i saj organizues shtrihej në tërë Zvicrën. Për shkaqe të ndryshme objektive e subjektive, nga viti shkollor 2000/01 kanë pushuar së vepruari këshillat në këto kantone: Appenzell, Graubünden, Glarus, Uri e Tessin. Moshfeksionimi i këshillave në këto kantone ka ndikuar në dobësimin e funksionimit të rrjetit të përgjithshëm organizues të Lidhjes. Zhvillimi i mësimit plotësues nga viti shkollor 1990/1991 e këtej është arritur falë angazhimit e punës vullnetare të këshillave komunale, rajonale e kantonale dhe angazhimit të një pjese të konsiderueshme të mësimeve shembullorë, të përkushtuar e të përgjegjshëm, të cilët, edhe pse nuk janë paguar rregullisht nga prindërit, e kanë zhvilluar dhe vazhdojnë ta zhvillojnë mësimin plotësues për hir të nevojave të nxënësve.

Në Konferencën e Parë Kombëtare të Shkollave Shqiptare në Diasporë (Bernë, 6-9 qershor 2003), LAPSH “Naim Frashëri” është rinjohur nga institucionet relevante politike,

arsimore, shkencore e kulturore të hapësirës shqiptare, bartëse e vetme zyrtare e SHSHMPZ-së dhe drejtuese e Këshillit të Përkohshëm Koordinativ-Konsultativ të SHSHMP-së në Diasporë (*Ministria e Arsimit dhe e Shkencës e Shqipërisë, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë e Kosovës, Ministria e Arsimit e Maqedonisë, Ministria e Kulturës, e Sportit dhe e Çështjeve Jorezidente të Kosovës, Ministria e Mbrojtjes së Pakicave e Malit të Zi, Subjekti politik i Luginës së Preshevës - Asambleja e Preshevës, e Bujanocit, Instituti i Diasporës Shqiptare i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Instituti i Studimeve Pedagogjike të Shqipërisë dhe Zyra për Zhvillimin dhe Përparimin e Arsimit të Maqedonisë*).

LAPSH-ja ka kontribuar në mënyrë të vazhdueshme dhe të specifikuar. Nga fillimi i viteve të 90-ta e deri sot, ajo e ka zhvilluar procesin mësimor në mënyrë të rregullt, në bazë të programeve të sistemit shkollor të Republikës së Kosovës për mësimin plotësues për nxënësit në Zvicër.

Ministria e Diasporës, e themeluar në vitin 2011, e ka ngritur dhe e ka shtruar nevojën e institucionalizimit të mirëfilltë të mësimin plotësues jashtë vendit, si njëri ndër objektivat kryesorë edhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Për realizimin e këtij objekti, LAPSH-ja ka ofruar gjithë përvojën dhe konceptin e vet përparimtar për zgjidhjen e mundshme, të arsyeshme dhe efektive për procesin mësimor, me kompetenca të plota institucionale, që do të realizohen dhe do të udhëhiqen nga MeD-ja, MASHT-i dhe nga MPJ-ja, sipas Ligjit të Diasporës dhe të Mërgatës së Kosovës, si dhe ligjeve të tjera në fuqi.